

## RELACION

### PËR

#### **PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 7905, DATË 21.3.1995, ‘KODI PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË’, TË NDRYSHUAR”**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Ministria e Brendshme, duke filluar nga muaji shtator i këtij viti, ka ndërmarrë një paketë të re masash për rritjen e sigurisë së të rinjve në të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar.

Në kuadër të kësaj pakete, Ministria e Brendshme propozon një qasje të re penale në raport me veprat që vënë në rrezik apo çenojnë jetën dhe shëndetin e fëmijëve brenda shkollave dhe në perimetrin e sigurisë rreth tyre, të quajtur në projektligjin e propozuar “Perimetër i Sigurisë” në shkolla.

Ndryshimet ligjore të propozuara parashikojnë ashpërsimin e dënimit për veprat penale që kryhen në mjediset e institucioneve arsimore ose në Perimetrin e Sigurisë së tyre, për vepra penale veçanërisht të rrezikshme për të rinjtë, si:

- Dhuna seksuale (neni 107/a);
- Pornografia (neni 117);
- Trafikimi i të miturve (neni 128/b);
- Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit (neni 278);
- Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta (neni 279);
- Prodhimi dhe shitja e narkotikëve (neni 283);
- Përshtatja e lokalit për përdorim droge (neni 285/a);
- Hedhja ose braktisja e shiringave (neni 285/b);
- Nxitja për përdorimin e drogës (neni 286);
- Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt (neni 291).

Kryerja e veprave penale në mjediset e institucioneve arsimore ose në Perimetrin e Sigurisë së tyre parashikohet si rrethanë rënduese edhe për të gjitha veprat e tjera penale të kryera në këto mjedise, nëse personat e dëmtuar janë të mitur.

Qëllimi i propozimit të këtij projektligji është garantimi i sigurisë, jetës dhe shëndetit të fëmijëve, dhe parandalimi i kriminalitetit në të gjitha ato hapësira fizike brenda dhe përreth shkollave, ku fëmijët qëndrojnë, ndërveprojnë dhe kalojnë pjesë të kohës së tyre para apo pas orarit të mësimi.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektakt nuk është i parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2023 për Ministrinë e Brendshme. Hartimi i këtij projektakti vjen si pasojë e politikave prioritare të ndjekura nga Ministria e Brendshme për garantimin e sigurisë dhe parandalimin e kriminalitetit në mjediset e frekuentuara nga nxënësit e shkollave.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Së pari, parashikohet për herë të parë në këtë projektligj koncepti i Perimetrit të Sigurisë në shkolla, për efekt të parashikimit si rrethanë rënduese apo cilësuese të disa veprave penale.

Me “perimetër të sigurisë” do të kuptohen të gjitha ato mjedise fizike në afërsi të institucioneve arsimore të cilat frekuentohen zakonisht ose, në çdo rast, potencialisht nga fëmijët a nxënësit e këtyre institucioneve arsimore.

Sipas përkufizimit në ligjin nr. 69/2012, termi “institucion arsimor” përfshin të gjitha shkollat dhe kopshtet e sistemit parauniversitar privat dhe publik (duke përfshirë, pra, vetëm universitetet).

Parashikohet si rrethanë rënduese “kryerja e një vepre penale në dëm të një të mituri në mjediset e një institucioni arsimor ose në perimetrin e sigurisë së tij”.

Kjo rrethanë rënduese zbatohet për të gjitha veprat penale që kryhen brenda perimetrit të sigurisë në dëm të të miturve.

Për vepra të tjera, si “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, “Dhuna seksuale”, “Pornografia”, “Trafikimi i të miturve”, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”, “Përshtatja e lokalit për përdorim droge”, “Hedhja ose braktisja e shiringave”, “Nxitja për përdorimin e drogës”, “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, kryerja e veprës brenda Perimetrit të Sigurisë, kryerja e një vepre penale në mjediset e një institucioni arsimor ose në perimetrin e sigurisë së tij përbën rrethanë cilësuese sipas parashikimeve në nenin përkatës, pavarësisht nëse destinatarët e veprës apo të dëmtuarit janë persona të mitur.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektakti është hartuar në mbështetje të nenit 81, paragrafi 1, si dhe nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *acquis* të BASHKIMIT EVROPIAN (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Projektakti nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektligji që propozohet është i përbërë nga 13 nene, si vijon:

Neni 1

Në nenin 50 “Rrethanat rënduese”, shtohet paragrafi “ë” me këtë përmbajtje:

ë) kryerja e një vepre penale në dëm të një të mituri mjediset e një institucioni arsimor ose në perimetrin e sigurisë së tij.

Neni 2

Në nenin 107/a “Dhuna Seksuale”, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Kur kjo vepër kryhet brenda ose në perimetrin e sigurisë së institucionit arsimor të frekuentuar nga i dëmtuari dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet”.

Neni 3

Në nenin 117 “Pornografia”:

Pas paragrafit të parë, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Kur kjo veper kryhet mjediset e një institucioni arsimor ose në perimetrin e sigurisë së tij, dënohet me burgim nga tre deri në pesë vjet”.

Pas paragrafit të tretë, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Rekrutimi, përdorimi, shtrëngimi ose bindja e një të mituri për të marrë pjesë në shfaqje pornografike, kur kryhet në mjediset e një institucioni arsimor ose në perimetrin e sigurisë së tij, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet”.

Neni 4

Në nenin 128/b “Trafikimi i të miturve”, shtohet paragrafi si vijon:

“Kur kjo veper kryhet në mjediset e një institucioni arsimor ose në perimetrin e sigurisë së tij, dënimi me burgim shtohet me  $\frac{1}{4}$  e dënimit të dhënë”

Neni 5

Në nenin 278 “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe I municionit”, pas paragrafit të parë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Kur kjo veper kryhet në mjediset e një institucioni arsimor ose në perimetrin e sigurisë së tij, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet”.

Neni 6

Në nenin 279 “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta” pas paragrafit të dytë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Mbajtja e armëve të ftohta si shpatat, bajonetat, thikat dhe mjete të tjera të përgatitura e të destinuara posaçërisht për sulm kundër personave ose për vetëmbrojtje, pa lejen e organeve kompetente, në mjediset e një institucioni arsimor ose në perimetrin e sigurisë së tij, dënohet me burgim nga tre deri në gjashtë vjet”.

Neni 7

Në nenin 283 “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Kur kjo veper kryhet në mjediset e një institucioni arsimor ose në perimetrin e sigurisë së tij, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet”.

Neni 8

Në nenin 285/a “Përshtatja e lokalit për përdorim droge”, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Kur kjo veprë kryhet në perimetrin e sigurisë së një institucioni arsimor, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet”.

Neni 9

Në nenin 285/b “Hedhja ose braktisja e shiringave”, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Kur kjo veprë kryhet në mjediset e një institucioni arsimor ose në perimetrin e sigurisë së tij, dënohet me burgim nga një vit deri në tre vjet”.

Neni 10

Në nenin 286 “Nxitja për përdorimin e drogës”, paragrafi i dytë zëvendësohet nga paragrafi më këtë përmbajtje:

“Kur nxitja apo injektimi i detyruar bëhet ndaj fëmijëve apo në mjediset e një institucioni arsimor ose në perimetrin e sigurisë së tij, në institucione penale, sportive apo të çdo veprimtarie tjetër shoqërore dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 11

Në nenin 291 “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, pas paragrafit të parë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Kur kjo veprë kryhet në perimetrin e sigurisë së një institucioni arsimor dënohet me burgim nga një vit deri në tre vjet”.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatimin e aktit që propozohet janë organet e sistemit gjyqësor.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektakti është hartuar nga Ministria e Brendshme.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Ky projektakt nuk shoqërohet me efekte financiare në buxhetin e shtetit.

**MINISTRI I BRENDSHËM**

**TAULANT BALLA**